



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – RepublicofKosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**Të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 8.5.2024, e cila filloi në orën 11:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina ( i pa varur), kryesues i Kuvendit, Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Arbër Limani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB).

**Munguan:** Berat Lahu (LVV), Bahri Gashi (AAK), Berna Saraçi (LVV), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha, drejtore e Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Arber Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, të medieve dhe përfaqësuesit e qytetarëve të lagjës " Kalabria".

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Faqe1nga13

Para se të fillohet me diskutimin e pikave të rendit të ditës, përfaqësuesi i lagjes "Kalabria" kërroi nga kryetari i Komunës të dijë, se çka është duke ndodhur me planin rregullativ të kësaj lagjeje.

**Përparim Rama**, kryetar thas e lagja "Kalabria" e ka planin rregullativ ekzistues dhe ai koeficient i cili ka qenë ai do të jetë, kështu që në mbledhjen e radhës së Kuvendit do të jetë në rend dite për diskutim dhe votim.

**Jeta Rafuna-Hasani**, propozoi që në rend dite të hyn edhe pika: Propozim - vendim për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe 2024.

**Kryesuesi** tha se për këtë propozim dje në mbledhjen e KPF-së u dakordua që ky propozim të shtyhet më vonë, me e shikuar mundësinë se si me i'u qasë kësaj.

**Gëzim Sveçla**, propozoi që në rend të ditës të hynë edhe pika: Propozim - vendimi për formimin e komisionit për verifikimin e ngjarjeve të ndodhura në mbledhjen e jashtëzakonshme të dt. 14.03.2024.

**Gëzim Mehmeti** tha se është për të ardhur keq në çfarë gjendje kemi ardhur, ku në muajin mars të vitit 2022 kam tërhequr vërejtjen që ky anulim do të ketë pasoja. Në këtë rast kisha kërkuar një sqarim, nëse iu thuhet banorëve që ata kanë pasur mundësi të procedojnë me leje dhe me cilën, me planin e kaluar që ka qenë 2013 apo me planin që është votuar në vitin 2021 në Kuvend pastaj është anuluar në 2022.

**Përparim Rama**, kryetar, propozoi që në rend dite të hynë pika Propozim - vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për znj. Elza Ujkani e lënduar me rastin e fatkeqësisë natyrore.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket çështjes së planit rregullues për lagjen "Kalabria", shqetësimet e qytetarëve janë të arsyeshme dhe të drejta, për shkak fatit të tyre dhe jetesës që bëjnë në pritje të një plani i cili është refuzuar në vitin 2022. Sot jemi 2 vjet më vonë dhe zotimi për kohën që do të vjen një plan më i mirë për 6 muaj nuk është mbajtur dhe për këtë duhet të jemi të sinqertë dhe të komunikojmë drejtë.

Lidhur me shqetësimet dhe çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Ramma, kryetar dhe Alban Zogaj, nënkyetar.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet e dhëna për rendin e ditës.

**Kryesuesi konstatoi se më 16 vota për dhe 25 vota kundër, nuk u miratua propozimi i z. Jeta Rafuna.**

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 13 vota kundër, u miratua propozimi i z. Gëzim Sveçla.**

**Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 1 votë kundër, u miratua propozimi i z. Përparim Rama, kryetar.**

**Me propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 39 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Raporti vjetor i punës së Kryeqytetit për vitin 2023;**
- 2. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2023 (TM4);**
- 3. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2023;**
- 4. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 janar – 31 mars 2024 (TM1);**
- 5. Propozim – vendimi për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera pas vërvshimeve të mëdha që kanë ndodhur në Komunën e Prishtinës në vitin 2023;**
- 6. Propozim – vendimi për vënien në konsultim publik për Projekt rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;**
- 7. Propozim – vendimi për formimin e komisionit për verifikimin e ngjarjeve të ndodhura në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 14.03.2024;**
- 8. Propozim – vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për znj. Elza Ujkani e lënduar me rastin e fatkeqësisë natyrore;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**
- 10. Të ndryshme.**

#### **Pika e parë**

#### **Raporti vjetor i punës së Kryeqytetit për vitin 2023**

Lidhur me punën e kabinetit të kryetarit të Komunës për periudhën 1 vjeçare, 2023 të pranishmit i informoi Përparim Rama, kryetar i cili tha se mbrenda kësaj periudhe 1 vjeçare kemi arritur ta përmbyllim një vit me shumë punë të kryera me rezultate të prekshme e me shumë projekte të reja, si në infrastrukturë dhe në fusha të tjera.

**Gëzim Sveçla** tha se është për keqardhje shumë zhgënjesë dhe thellësisht shumë dëshpëruese qasja e të parit të kryeqytetit në raport me Kuvendin Komunal, në raport me obligimin e tij si kryetar e mbi të gjitha në raport me qytetarin e Prishtinës. Dokumentin të cilin do duhet t'i kushtonte jashtëzakonisht rëndësi, ku do të duhet të ishin të listuara e të renditura një nga një punët eventuale, kryetari Rama na ka dërguar në formë të një foto albumi që ngjason me ato fletushkat e marketeve që i reklamojnë zbritjet e çmimeve përfundjavë. Mbase këtu ka edhe një lidhje logjike sepse kryetari Rama edhe ky ekzekutiv në përgjithësi ashtu edhe e konceptojnë qeverisjen e qytetit reklamë dhe çmime, reklamë përpak punë. Ky raport është dashur të diskutohet në këtë Kuvend qysh në muajin janar e jo tanë kur jemi gati në gjysmën e vitit. Besoj se tanë është mëse shumë e qartë se raportimet

Faqe3nga13

vjetore si ky sot ju do ta keni vetëm edhe një në janarin e vitit 2025 mandati juaj po përfundon e bashkë me të edhe kjo ëndërr e keqe e qytetarëve të Prishtinës. Deri tani mbaheni mend për të gjitha këto që i potencuam më lartë.

**Jeta Rafuna-Hasani** tha se kryetari Rama edhe një herë me raportimin sot po dëshmon transparencën ndaj nesh si asamblistë si përfaqësues i qytetarëve duke raportuar në çdo periudhë kohore duke filluar nga 100 ditëshi pastaj 6 mujori i vitit 2022 dhe tani para nesh kryetari Rama me ekipin e tij kanë sjellë raportin për vitin 2023. Kryetari Rama bashkë me ekipine tij jan duke bërë një punë të shkëlqyeshme në arrijen edhe të përmbushjes së projekteve të mëdhaja. Ky përkushtim serioz dhe kjo punë e madhe do të sjellë edhe rezultatet e saja.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket raportit vjetor të punës të kryetarit, kemi menduar se do ta kemi të paktën një raport të ndërtuar me më shumë përbajtje e strukturë e më pak fotografi, por këtu më shumë kemi marrë faqe të zbrazëta se sa përbajtje. Sa i përket disa punë të cilat janë kryer nga Drejtoria e Investimeve Kapitale e shohim një dinamikë më ndryshe, është pozitive mirëpo çka vazhdon të jetë trend negativ është numri i lartë i suficitit apo mjeteve të parealizuara. Vlenë të theksohet se shumë projekte të filluara nga ish drejtorët nga radhët e subjektit politik të PDK-së janë realizuar e ëshë për të ardhur këq që këto punë të cilat jan kryer nuk jan përfshirë fare në këtë raport, kështu që minimalisht është dashur që autorësia e tyre të njihet dhe të vlerësohet.

**Gëzim Mehmeti** tha se duke analizuar raportin, ne shohim se 60% janë të mbuluara me fotografi artistike. Të afrohet një raport prej 22 faqeve për një vit të tërë kalendarik, kjo do të thotë gjithçka edhe nga ato nuk janë formulim as diku 10 faqe. Po ashtu shumica e premtiveve janë të ish mandatit të kaluar edhe projekteve, ndërsa sa i përket premtiveve të cilët i ke dhënë z. kryetar prej 206 premtimveve janë të përfunduara vetëm 26 që i bie as 10% në nivelin e realizimit.

**Fehim Osmani** tha se ky raport i cili na është prezantuar është i mbushur me shumë foto dhe ka shumë pak informata. Shumica e punëve të rapportuara janë të papërfunduara ose janë në proces e sipër të cilat janë të paraqitura si projekte ose të kryera ose si sukses për vitin 2023. Flitet për shumë projekte të cilat kanë filluar e kanë shpenzuar buxhetin, mirëpo ose janë kryer me cilësi shumë të dobët ose nuk kanë përfunduar fare. Mendoj se raportet e tillë herëve të tjera duhet të kenë shumë më shumë përbajtje.

**Granit Geci** tha se është dashtë që në këtë raport me qenë edhe një falënderim me emra personal, edhe për ish drejtorët Ilirik Musliun, Besiana Musë Murati, Granit Rugovën, Arta Balaj, Plator Gërdovcin edhe më së shumti ndoshta për ish nënkyetaren Donjeta Sahatçiu, të cilëve ua ke pa mundësuar ta vazhdojnë punën e tyre të mirë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Alban Zogaj, nënkyetar.

**Pika e dytë, Raporti finansiar buxhetor i kryeqytetit për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2023 (TM4) dhe**

**Pika e tretë, Raporti finansiar buxhetor i kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023.**

Lidhur me Raportin finansiar buxhetor të kryeqytetit për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2023 (TM4) dhe Raportin finansiar buxhetor të kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

**Mirsad Vitia** tha se Raporti finansiar buxhetorë i Kryeqytetit për periudhën 1 janari 31 dhjetorë 2023 diskutohet më 5 muaj vonesë. Ky rapport ka shumë detaje teknike dhe shifra është e vështire që mos të vërehen disa çështje thelbësorë që duhet të adresohen.

Kur analizojmë të hyrat vetanake për vitin 2023, shohim së nuk ka të dhëna për taksat në transaksionin në pronë në krahasime me vitet e kaluara, gjithashtu kemi rënien nga të hyrat e qirave nga banesat etj. Shpenzimet për vitin 2023 në kategoritë e ndryshme janë tejet sheqtësuese, kështu që gjatë periudhës janar -dhjetorë 2023 janë shpenzuar në total mbi 114 milion euro. Me këtë qeverisje të Përparim Ramës, Prishtina vazhdon të ngulfatët nga mbeturinat, vazhdon kaosi në trafik, vazhdojnë kërcënimet nga qentë endacak etj.

**Fitnate Bejta** tha se ky rapport ka të bëjë me shifra ekzistues faktike që i prezantojnë drejtoritë dhe janë të koordinuara në bazë të buxhetit të planifikuar për atë vit.

Të hyrat vetanake për vitin 2023 kanë qenë në nivelin e kënaqshëm të realizimit, ku nga të hyrat vetanake janë inkasuar 34.7 milion euro. Po ashtu shpenzimet për subvencione për vitin 2023 janë realizuar në vlerë 95,28%. Mendoj se tek realizimi i shpenzimeve kapitale rreth 50% janë ekzekutuar punë më shumë dhe si grup parlamentar jemi të kënaqur për ketë rritje 104% në krahasim më vitin 2022.

Ky rapport finansiar është i kënaqshëm edhe pse ne nuk duhet te jemi gjithmonë te kënaqur me punën tonë, por gjithmonë duhet të dëshirojmë të arrijmë më shumë suksese.

**Leutrim Retkoceri** tha se si pikë e dobët e raportit mbetet të jetës suficit i lartë mbi 50 milion euro të pa realizuar dhe kjo do të shërben si mësim për vitin 2024. Komuna ka mjete por nuk po mundet me i realizuar projektet, kjo është një pikë e dobët që e ka përcjellë edhe qeverisjen para kësaj. E dim që kemi shumë projekte që ende nuk kanë filluar, ka projekte që kanë mbet në gjysmë dhe ka projekte të zotuara e të cilat as që kanë filluar. Uroj që rapporti tjetër të jetë shumë më i mirë.

**Gëzim Mehmeti** tha se shqetësuese është relacioni me shpenzimet buxhetore dhe buxhetin për vitin 2023. Në rapport janë cekur shpenzime për të cilat nuk kemi as një njohuri ku dhe si janë shpenzuar ato mjete. Po ashtu shumë shqetësuese është edhe çështja e ndërmarrjeve Komunale ku na rregullisht po i subvencionojmë ato. Mendoj se këtu duhet të behet një studim i fizibilitetit të mirëfilltë që ato në mesë vetit të ndihmojnë njëra tjetrën dhe mos të vijë në Kuvendë të ketë kërkesa të tillë .

**Nora Kelmendi** ngriti shqetësim rrëth disa kategorive buxhetore, ku realizimi i të hyrave për ato kategori është shum i ulët, siç janë qeraja në banesa, te shpronësimet, si dhe të hyrat në disa ndërmarrje për këtë periudhë kan qenë në rënien e sipër. Sa i përkthim shpenzimeve kapitale, prej 86 milion euro të ndara për vitin 2023 janë realizuar vetëm 43%, kështu që kemi një realizmim shumë të ulët të projekteve kapitale. Nga kjo shihet se shumica e drejtorive nuk e kanë realizuar as 50% të buxhetit të planifikuar.

**Gëzim Sveçla** kërkoi të dijë se çka paraqesin disa shifra të cilat janë të pasa qyruan në raport siq është ajo e 3.000.900 euro te ndërmarrja "Pastrimi", mandej është një kontratë për shërbime të veçanta në ndërmarrjen "Kuzhina qendrore", kërkoi të dij se për çfarë kontrate bëhet fjalë. Po ashtu për një marëveshje për bashkëfinancim për digitalizimin e vend parkingjeve publike në "Prishtina Parking", në vlerën prej 500 mijë euro, si dhe për një një marëveshje me "Islamik Relief Kosova" për mbështetjen e mekanizmave bujqësorë në vlerë prej 20 mijë euro.

**Feim Osmani** tha se shifratët të cilat janë të pasqyruan në këtë raport që tregojnë rrëth performancës së shpenzimeve buxhetore, konsideroi se nuk janë të sakta. Shuma e mjetave prej 140 milionë euro janë të shpenzuar, ndërsa të gjitha përqindjet tjera janë llogaritur në bazë të shumës së shpenzuar dhe jo në bazë të buxhetit i cili ka qenë i dedikuar për vitin 2023. Mendoj se kjo është bukur shqetësuese nuk është përtu krenuar as pakë, mirëpo duhen të merren masa që në të ardhmen të ketë shumë me pakë shpenzime dhe shumë më shumë investime.

**Muhamed Selmani** tha se në mos realizimin e projekteve kapitale mendoj se mungesa e stafit ka ndikuar në mos realizimin e tyre, kështu që do të ishte mirë që të investohet në staf profesional, konkretisht të rritet stafi në zyrën e prokurimit etj.

**Faton Zeka** tha se do të ishte mirë që të merret një iniciativë që do ta rregullonte çështjen e tatimit në pronë për disa objekte, kështu që do të krijohej një mundësi më e madhe për Drejtorinë e Financave me inkasuar mjetet nga tatimi në pronë.

**Ermal Osmani** kërkoi të dijë arsyen e humbles së 8 milion euro të të grandit Qeveritar, pse ka ndodhë kjo.

Lidhur me vërejtet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhan Valbona Makolli, drejtore, Alban Zogaj, nënkyetar dhe Krenar Xhaferi, drejtor.

### Pika e katërt

#### Raporti Financiar Buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 Janar – 31 Mars 2024 TM1.

Lidhur me ketë pikë te pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drjtore.

**Mirsad Vitia** tha se sa i përket shpenzimeve në projektet kapitale për periudhën janar – mars 2024 sa i përket drejtorive, shihet se disa drejtori kan shpenzuar shumë pak mjete në realizimin e projekteve të tyre, si psh Drejtoria e Administratës as 9% se ka realizuar

buxhetit, Drejtoria e Parqeve 0%, as një investim, Drejtoria e Investimeve Kapitale me një progres prej 1.51%, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka shpenzuar 21.65%, shiht se ka një rritje, Drejtoria e Bujqësisë 0 % progres, Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencës po ashtu njëjtë, si dhe drejtoritë e tjera me një përqindje shumë të vogël të realizimit të projekteve të tyre.

**Fikneta Bejta** tha se sa i parket performances buxhetore, krahasimi me vitet paraprak dhe me periudhat paraprake nuk i vendos drejtoresha apo as ndonjë institucion, mirë po këto janë me standardet ndërkomëtare të raportimit financiar, që gjithmonë për bazë i marrim periudhat e njëjtë krahasuese. Sa i përket kategorive tjera të shpenzimeve e vërejmë që te kategoria e pagave janë shpenzuar në nivel të kënaqshëm me 28.82%, në mallrat dhe shërbimet janë 17.54% dhe shpenzimet komunale ka realizim 10. 57%, subvencionet 3.65%. Vlenë të theksohet se shpenzimet kapitale janë një shifër e kënaqshme nëse i krahasojmë me periudhën e parë të vitit 2023.

**Fatmir Dervishi** tha se te kategoria e shpenzimeve, pagave dhe mëditjeve vërejmë që ka rritje prej 28.82% në krahasim më vlerën e përgjithshme, ndërsa te kategoria e shpenzimeve kapitale kemi një shpenzim prej 2.82% që është me të vërtet situatë jo e mirë. Vërejmë se në shumë drejtori shpenzimet i kemi zero, pastaj kemi në Drejtorin e Investimeve Kapitale 1.51%, Drejtorinë e Shërbimeve Publike 21.65 %, te Drejtoria e Bujqësisë kemi zero investim, te Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencës zero investim, si dhe drejtoritë e tjera me një performancë shumë të ulët në realizimin e projekteve të tyre.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parfolësit, sqarime të nevojshme dha Valbona Makolli, drejtore.

#### **Pika e pestë**

**Propozim - vendimi për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet e tjera pas vërvshimeve të mëdha që kanë ndodhur në Komunën e Prishtinës në vitin 2023**

Lidhur me këtë propozim-vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Lulzim Fushtica, drejtore.

**Feim Osmani** tha se, duke e marrë për bazë raportin e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet tjera, konstatojmë se as ky raport nuk dallon shumë nga ai i kaluari, as për vërejtjet e paraqitura nga ana jonë e as nga metodologjia e punës . Se pari duhet te konstatojmë se edhe ky raporte po qe miratohet sot nuk i plotëson kriteret ligjore metodologjike për disa arsyen e njëra nga me kryesorët se nuk është marrë parasysh vërejta që lista e përfituesve të publikohet dhe të ju jepet mundësia të refuzuarve që ti paraqesin ankesat e tyre nëse jo për arsyen tjetra së paku për tëplotësuar kushtin ligjore. Pavarësisht vërjetjeve që ne i kemi dhënë në seacën e kaluar por edhe që i kemi edhe tanë, ne do të votojmë pro këtij rapporti dhe prap do të kërkojmë sqarime shtesë, jo për faktin se rapporti meriton votën, po për arsyen që bujqit janë vonuar padrejtësisht me shumë se 6 muaj në realizimin e kësaj të drejte.

**Dhurata Jahaj – Retkoceri** tha se pas formimit te komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, komisioni gjithsej ka pranuar 155 kërkesa për vlerësimin e dëmeve dhe pas vlerësimit te tyre komisioni nga 155 kërkesa prej te cilave 116 kërkesa janë aprovuar dhe 39 janë refuzuar pasi qe nuk kanë plotësuar kriteret sipas udhëzuesit për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, andaj kërkoj nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta vlerësojnë ketë raport sepse është shume i rëndësishëm për bujqit.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket raportit të dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore që ishte prezantuar në një seancë te jashtëzakonshme, vërejtjet dhe sugjerimet që i kanë bërë shumica e anëtareve të Kuvendit kanë rezultuar të drejta, kështu që si GP i PDK-së do të votojmë pro këtij reporti natyrisht pas diskutimeve tjera ku do të kërkojmë sqarime shtesë, jo për faktin se rapporti meriton votën, po për arsy që bujqit janë vonuar padrejtësisht më shumë se 6 muaj në realizimin e kësaj të drejtë.

**Gëzim Mehmeti** tha se vërejtjet të cilat ne i kemi dhënë kanë dhënë një efekt por jo edhe aq të pritshëm. Ky report prapë nuk është perfekt ka mangësi dhe kisha dëshiruar që të kaloj edhe kjo çështje. Unë do ta përkrahi, do ta votoj edhe pse ka shume për të diskutuar, mirëpo nuk pritet më nga këto rrëthana që janë te krijuara që te ketë diskutime dhe humbje kohe.

**Muhamed Selmani** tha se do ta përkrahu këtë report për miratim dhe uroj që të kaloj dhe mos të na kthehet prapë për të shkaktuar vonesa nga agjencioni. Për këtë rapot kam disa vërejtje si psh te mënyra e vlerësimit të parcelave etj. E përkrahim këtë report por kisha kërkuar që nëse është e mundur të hapet një mundësi e ankesës së cilës palë e cila është e pa kënaqur dhe e cila mund ta sjell dokumentacionin e që at dokumentacion me e vlerësuar një komision tjetër. Mendoj se për evitimin e dëmeve nga vërshimet e ujit do të ishte më se e domosdoshme rregullimi i shtartit të lumit Llap.

**Nora Kelmendi** tha se ky report i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara që na është sjellur sot nuk është i nënshkruar nga kryetari. Në mbledhjen e KPF-së u diskutua që ky report të sillet në Kuvend i nënshkruar nga kryetari, pra është dasht të nënshkruhet e pas mendimit të komisionit dhe të sillet në Kuvend, prap nuk është i nënshkruar.

**Gëzim Sveçla** tha se si grup parlamentar, për kundër gjitha këtyre shkeljeve, përkundrazi gjithë këtyre dyshimeve të ngritura për hirë të buqëve po e votojmë dhe po e përkrahim duke shpresuar që do t'iu jemi pranë në këto momentet kur ata do të bëjnë ankesë dhe gjëra të tillë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga nëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Lulzim Fushtica, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, u miratua Vendimi për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera pas vërshimeve të mëdha që kanë ndodhur në Komunën e Prishtinës në vitin 2023.**

## Pika e gjashtë

### Propozim - vendimi për vënien në konsultim publik për Projekt rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës

Lidhur me këtë propozim vendim të pranishmit në pika ë shkurtra i informoi Jehona Lushaku, nënkyetare e Komunës.

**Nora Kelmendi** tha se kjo rregullore e cila duhet të dërgohet në dëgjim publik është pothuajse e ngjasheme me rregulloren e vjetër me disa ndryshime të vogla kozmetike të cilat me siguri i shkojnë për shtati kryetarit dhe kabinetit të tij. Shpresoj që pas dëgjimeve publike do të finalizohet rregullorja dhe ndarja e subvencioneve do të bëhet përmes thirrjeve publike bazuar në kriteret e përcaktuara.

**Pellumb Bajqinovci** tha se kryetari Rama ka themeluar një grup punues i cili e ka përfshi edhe pjesën e kabinetit të tij edhe drejtoret dhe mendoj se kjo draft rregullore sigurisht se ka nevojë për ide apo përsugjerime, përmisime për të cilat pas votimit të kaloj në ndëgjim publik. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës duhet të përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, do të ketë kritere ma shumë, dokumente të nevojshme edhe informata të cilat janë shumë të rëndësishme.

**Leutrim Retkoceri** tha se kjo rregullore ka mangësi të mëdha, si procedurale ashtu edhe përbajtsore dhe si e tillë kjo rregullore në këtë formë pa propozuesin e vet këtu nuk mund të shkoj në dëgjim publik sepse i vënë në lajthitje qytetarët dhe ne nuk mundemi ta votojmë për me dal në dëgjim publik.

**Gëzim Mehmeti** tha se kjo rregullora ka shum mangësi dhe si e tillë është e pa pranueshme dhe nuk do ta votoj.

**Gëzim Sveçla** tha se këtë rregullore nuk do ta votojmë për me e dergu në diskutim publik, të mbetet për seancën e radhës duke shpresuar që z Rama do të na jap një prezantim siç duhet, pasi që kjo rregullore prek shumë aspekte ligjore.

**Duke pasur parasysh vërejtet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, kryesuesi tha se, me propozimin e znj. Jehona Lushaku, nënkyetare e Komunës, kjo rregullore nuk procedohet më tutje dhe largohet nga rendi i ditës.**

## Pika e shtatë

### Propozim - vendimi për formimin e komisionit për verifikimin e ngjarjeve të ndodhura në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 14.03.2024

**Gëzim Sveçla** tha se propozimi ka të bëjë me formimin e komisionit për analizimin e ngjarjeve të ndodhura në Kuvend në mbledhjen e dt. 14 mars 2024.

Për anëtar të komisionit nga LVV-ja, të propozuar janë Feim Osmani dhe Arianit Beqiri.

**Jeta Rafuna**, për anëtar të komisionit nga GP i LDK-së, propozoi Amir Simnicën.

**Leutrim Retkoceri**, për anëtar të komisionit nga GP i PDK-së, propozoi Fatmir Dervishin.

**Kryesuesi** tha se mbetet që ekzekutivi ta propozon një përfaqësues për anëtar të këtij komisioni.

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 2 vota kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për formimin e komisionit për verifikimin e ngjarjeve të ndodhura në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 14.03.2024**

**Pika e tetë**

**Propozim – vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për znj. Elza Ujkani e lënduar me rastin e fatkeqësisë natyrore**

**Lulzim Fushtica**, drejtor, në emër të kryetarit të Komunës kërkoi nga të pranishmit që të votohet ky propozim vendim.

**Leutrim Retkoceri** tha se kjo pikë duhet të shtyhet, në mënyrë që mos të ketë precedentë për të cikat kryetari i Komunës vjen jepe propozime e na këtu i kalojmë me obligime ndaj tij. Asnjë obligim se kemi ndaj kryetarit të Komunës që të propozon e mos të jetë prezent të arsyetoj propozimet e tij.

**Gëzim Mehmeti** tha se ky votim i një propozimi të tillë do të ket pasoja, këto çështje duhet sdudijuar mirë, jam që të lënduares ti jepet ndihma, por ne në këtë aspekt po e hapim kutinë e pandores.

**Gëzim Sveçla** tha se nuk ka dikush këtu që nuk është për me ndihmuar vajzën e lënduar, por çasja se si është iniciuar kjo çështje nuk është në rregull, kështu që do të ishte mirë që ta arrijmë një përfundim i cili kishë me i shërbye gjithë këtij procesi. Megjithat mendoj që kemi nevojë për një konsultim mes grupeve ndoshta me vendos se si të veprojm tutje.

**Hafiz Krasniqi** tha se duke psur prasysh rstin se si ka ndodhur, kërkoi që ky propozim vendim të qitet në votim dhe secili të votojë me ndërgjegjen e vet

*Pas një konsultimi të shkurtër mes shefave të grupeve parlamentare, u konstatua se nuk kishte një marëveshje që kjo pikë të procedohet për votim.*

**Jeta Rafuna** tha se kryetari kur e ka propozu ka hy si pikë e rendit të ditës, përderisa pika nuk është térheqë nga propozuesi atëherë duhet të hidhet ne votim.

**Fikneta Bejta** tha se praktika edhe procedura është nëse një pikë ka hy në rend të ditës, nuk mundet me u térheq, vetëm ai që e ka propozu mundet me térheq në të kundërtën votimi duhet me u konsume, kjo oshtë procedura edhe praktika e Kuvendit Komunal.

**Ermal Osmani**, propozoi që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës.

*Pas këtyre diskutimeve, në shenjë paknaqësie, GP i LDK-së e lëshoi mbledhjen.*

**Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumit, kjo pikë e rendit të ditës nuk mnd të hodhet në votim.**

## Pika e nëntë

### Pyetje dhe përgjigje

#### **Feim Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorinë Drejtorisë së Adminmistratës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.**

- Zyra e oficarisë në Besi po ashtu edhe Zyra e Bashkësisë Lokale janë jo funksionale, ka tri vjet thuaqse prej se ka marr detyrën ekzekutivi i ri dhe qytetarët jashtëzakonisht po përjetojnë peripeti për një certifikatë të lindjes, për një ekstrakt, për një certifikatë familjare, një vërtetim të bashksësië familjare e çfarë do dokumenti tjetër çoftë.  
Shërbimet atje mbulohen vetëm dy herë në javë, ditën e martë dhe të enjte prej orës 10:00 deri në 12:00. Kërkoi që aty të vendoset një ofiqar si dhe referenti i Bashkësisë Lokale.
- Në fshatin Sharban dhe Rimanishtë ndërtimi i rrjetit të kanalizimit ka filluar më shumë se një vit, për cilësinë e punimeve kam raportuar disa herë këtu në Kuvend, që ka qenë jashtëzakonisht cilësi shumë e dobët ka shumë probleme të cilat unë i kam marr dhe kam raportuar dhe kam marr premtim nga drejtori se do të përkujdeset për pjesën për të cilën ka pasur shqetësim. Kërkoi të dij arsyen e ndërprerjes së punimeve, si dhe për kanalizimin e fshatit Rimanishtë kërkoi që të merren masa të vazhdojë projekti ashtu siç ka qenë i paraparë.
- Pse është ndërprerë kontrata për rregullimin e rrugicave në fshatin Vranidoll, pse nuk po vazhdon faza e rregullimit të rrugicave në këtë fshat.

#### **Gëzim Sveçla, për nënkryetaren e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe për drejtoren e Drejtorisë së Kulturës**

- Ka pretendime se në lagjen "Arbëria" ku në hapësirën sipas planit urbanistik është e paraparë ndërtimi i një shkolle dhe pikërisht në atë hapësirë sipas disa informatave që i kemi të pa konfirmuara po ndërtohet edhe edhe një ndërtesë, ku ndërtues është një familjar i një zyrtari të Komunës së Prishtinës.
- Pse është e nevojshme që të transportohen njëmbëdhjetë nxënës duke filluar nga klasa e parë prej fashtit Prapashticë për në shkollën model, ku bëjnë 30 kilometra rrugë, pothuajse ta kalojnë tërë ditën rrugëve dhe në shkollë nëse i kalojnë 11 shkolla të tjera, ku ekziston mundësia që të sistemohen pa e llogaritur këtu koston e këtij transporti që ndodhë.
- Eshtë tejet shqetësuese prania e minjëve në lagjet "Kalabria" dhe "Dardania", dhe a do të ndodhë procesi i deratizimit.
- Sipas një informacioni thuhet se, menaxhmenti i Pallatit të Rinisë i ka kushtëzuar me të drejtë apo pa të drejtë klubet sportive që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre, që nëse Komuna nuk e kryen borxhin ndaj Pallatit, këtë obligim janë të detyruar ta marrin klubet që ta paguajnë ndaj pallatit se në të kundërtën do të ju pamundësohet shfrytëzimi i sallave që janë aty.

- Pse nuk është i shpallur në veb faqe konkursi për drejtor të teatrit "Dodona".
- Në një kod buxhetor bashkë me rrugën "Antigona Fazliu" kanë qenë rruga "Maliq Pashë Gjinolli" dhe rruga "Mbreti Bardhyl", mirëpo kur është parashikuar fillimi i punëve në rrugët "Mbreti Bardhyl" dhe "Maliq Pashë Gjinolli" ka pasur një rezistencë të banorëve, nuk kanë lejuar që të fillojnë punët, arsyetimi mbasë edhe i drejtë i banorëve ka qenë se dinamika e punëve nëpër lagjet e tjera është shumë e ngadalshme edhe një hapje për punishte do të shkaktonte dëme të mëdha në aspektin e bizneseve që janë aty por edhe të familjeve që jetojnë aty. Kërkoi të dij se cilat jan planet për rregullimin e këtyre rrugëve.
- Ka një opinion ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me emërimin, në fakt në lidhje me formimin e drejtorive të reja dhe me fuzionimin e disa drejtorive që kanë ndodhur edhe ai opinion ligjor thotë se ky vendim i kryetarit Rama është shkelje e Statutit të Komunës së Prishtinës. Me Statut të Komunës së Prishtinës, Prishtina i ka 12 drejtori dhe për çdo ndryshim nevojitet fillimisht të ndryshohet Statuti pastaj të formohen drejtorit e reja. Cili është vendimi dhe cilat veprime i ka marr kryetari Rama që të kthehet ligjshmëria në ekzekutivin e Prishtinës.

Lidhur me pyetjet e ngritura nga z. Sveçla rreth ndërtimit të një ndërtese në lagjen "Arbëria" dhe për transpotin e nxënësve për në shkollën Model, si dhe për konkursin në tetarin "Dodona" përgjigje dhan Jehona Lushaku, nënkyetare e Komunës dhe Sibel Halimi, drejtore.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi zyrtarisht që të ket qasje në përgjigjen për lejen që i është dhënë atij ndërtuesi për objektin, ku sipas planit rregullues aty është paraparë ndërtimi i çerdhes ose kopshtit, për shkak se kush do çoftë që ka dhënë leje dhe ka toleruar një objekt i cili nuk është i dedikuar për kopsht me koeficient P+1 bënë shkelje të planit rregullues i cili nuk është ndryshuar.

#### Gëzim Mehmeti, për kryetarin e Komunës

- Një shqetësim shumë i madh është duke ndodhur me tenderin e ndriçimit. Kërkoi që ky skandal të jet në rend dite ne njëren nga mbledhjet e radhës së Kuvendit dhe që nga ZKA-ja dhe zyrtari kryesor i prokurimit të na shpjegon se çka kanë dashur me bërë këtu se ky është skandal që në Kosovë nuk ka ndodhur asnjëherë sa i përket specifikave dhe kritereve.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Mehmeti, përgjigje dha Bekim Brestovci, drejtor.

#### Besart Krasniqi, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

- A është ndërmarrë ndonjë iniciativë për fillimin e ndërtimit të Bibliotekës dhe Qendrës Kulturore për rini në lagjen "Kodra e Trimave".
- Shitësit ambullativ që janë statik në sheshin e Prishtinës, për qoshqet e reja për qiran mujore kanë paguar 310 euro, shumë kjo e pa përballuar për këta shitës ku

normal ata kërkojnë që kjo shumë të zbritet si dhe kërkojnë të vendosen në vendet adekuate ku nuk ju pengojnë institucionet për rreth.

- Banorët e lagjes "Ulpiana e re" në Hajvali, më konkretisht rruga "Hilmi Bajrami", kërkojnë të bëhet vendosja e policëve të shtrirë për shkak të tejkalimit të shpejtësisë që bëhet në atë rrugë që në këtë mënyrë duke rrezikuar edhe jetën e banorëve.
- Banorët e lgjës "Arbëria" ankohen për vendosjen e kontejnjerëve në parkingun e Komunës afér kopshtit "Shkronjat" si dhe shumë afér banesave të banimit ku këta kontejnjerë po paraqesin problem për banorët si në aspektin shëndetësor po ashtu edhe në atë fizik duke penguar hyrjet dhe daljet e qytetarëve, andaj ata ankohen që urgjentisht të largohen nga aty.
- Banorët e fshatit Sharban kërkojnë rregullimin e rrugës "Shaban Jashari" e cila është në gjendje shumë të rëndë dhe po paraqet problem për banorët.
- Në lagjën "Ulpiana", ruga "Motrat Qiriazi", Ulpiana 2 dhe 3, hyrja e dytë e kësaj lagje ka problem serioz me kulmin e ndërtesës i cili ka rezoltuar se është i dëmtuar shumë për shkak të depërtimit të ujit gjatë rreshjeve të shiut dhe hyrjes së shpezëve në brendësi të ndërtesës, andaj banorët kërkojnë që urgjentisht të bëhet rregullimi i kulmit të ndërtesës.

Lidhur me pyetjet e parashtruara rreth vendosjes së kontejnerëve dhe qoshqeve të shitësve ambulanator, përgjigje dha Bekim Brestovci, drejtor.

*Mbledhja përfundoi në orën 18:30.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kupina

